



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 4067 prot.

Pogradec, më 11.11 2025

VENDIM

Nr. 111, DATË 10/11 /2025

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 34 HA DHE 6600 m2, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e sipërfaqes së tokës bujqësore prej 34 Ha (Tridhjetë e katër) dhe 6600 m2 (gjashtëmije e gjashtëqind), të ndodhur në Njësine Administrative Çërravë, që mund të jepen me qera sipas listës.

Nr	Pro nesi a	Zona Kadastrale	Nr Pasurise	Vendodhja	Lloji	Siperfaqj a ne m2
1	Shte t	1387	348	Çërravë	Pa Fruteshme	16400
2	Shte t	1387	84/2	Çërravë	Pemëtoje	330200
					TOTALI	346600

2. Toka Bujqësore që do të jepet me qera do të shfrytëzohet vetëm për veprimtari bujqësore dhe të tjera veprimtari në funksion të saj, që lejohen në tokën bujqësore.
3. Afati i dhënies me qera do të jetë në përputhje me destinacionin e kultivimit por asnjëherë më i gjatë se afati i përcaktuar pikën IV të Udhëzimit nr.1, datë: 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara", dhe përcaktimeve të tjera ligjore.

¹Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com



4.Çmimi dysHEME i vlerës së qerasë nuk do te jete jo më pak se 6000 (gjashtëmije) lekë Ha në vit sipas pikës nr 10 të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".

5.Per zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike, si dhe Njësia Administrative Çërravë.

6.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 19 vota

2.Vota Pro 19

3.Vota Kundër 3

4.Vota Abstenim 2

5.Zbardhur më date 11.11.2025